

Në bazë të Konkluzionit të Qeverisë së Republikës së Serbisë mbi pranimin e Programit të masave mbi ndarjen dhe shfrytëzimin e mjeteve për subjektet ekonomike në pronësi private për vitin 2022, në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, 05 numër 401 – 3098/2022 të datës 14.04.2022, si edhe në bazë të nenit 31 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative, Shërbimi i Trupit Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (në tekstin e mëtejshëm: Shërbimi i Trupit Koordinues), më 09.05.2022,

shpall

KONKURS

për ndarjen e mjeteve për subvencione subjekteve ekonomike në pronësi private për vitin 2022, në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë

I VLERA E MJETEVE

Konkursi realizohet nga Shërbimi i Trupit Koordinues për ndarjen e fondeve në shumën prej 40.000.000,00 dinarë, përkatësisht për komunën e Preshevës në vlerë prej 15.400.000,00 dinarë, për komunën e Bujanocit në vlerë prej 16.600.000,00 dinarë dhe për komunën e Medvegjës në vlerë prej 8.000.000,00 dinarë.

Me fondet e përcaktuara do të financohen masat e mëposhtme:

- 1) për Masën I, përkatësisht për bashkëfinancimin e projekteve të sipërmarrësve të cilët kanë për tendencë rritjen dhe punësimet e reja.
- 2) për Masën II, gjegjësisht projektet e shoqërive të vogla ekonomike në përputhje me Rregulloren mbi Rregullat për Ndarjen e Ndhmës Shtetërore („Gazeta Zyrtare e RS-ës, nr. 13/10, 100/11, 91/12, 37/13, 97/13, 119/14, 23/21 –rregullores tjetër, 66/21 – rregullores tjetër dhe 99/21 rregullores tjetër), dhe në përputhje me Ligjin mbi Kontabilitet („Gazeta Zyrtare e RS-ës“ numër 73/19 dhe 44/21 – ligjit tjetër) klasifikohen në kompani mikro dhe të vogla (në tekstin e mëtejshëm: kompani mikro dhe të vogla), të cilat kanë tendencë për rritje dhe punësime të reja, dhe në përputhje të Rregullores mbi rregullat dhe kushtet për ndarjes e ndihmës me vlerë të vogël (ndihma de minimis) (Gazeta Zyrtare RS, nr 23/21).

Qëllimi i konkursit është financimi i pajisjeve/makinave për subjektet që plotësojnë kushtet e këtij konkursi.

Shërbimi i Trupit Koordinues do të bashkëfinancojë deri në 70% (neto) të shpenzimeve (pa TVSH) të prokurimit për masën I dhe masën II nga pika 1.3 e Programit për kompanitë mikro dhe të vogla dhe për sipërmarrësit.

Shpenzimet nuk përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar, pagesa e të cilit është detyrim ekskluziv i aplikuesit.

II KUSHTET E KONKURSIT

Të drejtë për të shfrytëzimin e mjeteve të pakthyeshme kanë subjektet ekonomike të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, si më poshtë:

- 1) subjektet juridike të kategorizuara si ndërmarrje mikro dhe të vogla;
- 2) sipërmarrësit;
të cilët janë të regjistruara në fushën e prodhimit dhe të shërbimeve në sektorët A - bujqësi, B - miniera, C – industri prodhuese, D - furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe klimatizim, E - furnizimin me ujë, menaxhim të ujërave të zeza, kontrollin e procesit heqjen e mbeturinave dhe si aktivitetet e ngjajshme dhe F - ndërtimtari (sipas klasifikimit të veprimtarive në përputhje me Rregulloren mbi Klasifikimin e Veprimtarive ("Gazeta Zyrtare e RS-ës", nr 54/10)) dhe në faqen e internetit të Institutit Republikan për Statistika (www.stat.gov.rs) dhe të cilat kanë seli në territoret e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. **Përfundimisht, mjetet mund të ndahen edhe në sektorin G – kur përveç tregëtisë në të madhe dhe të vogël, sipërmarrjet në afarizmin e tyre kanë edhe veprimtarinë prodhuese, dhe me këtë rast është e nevojshme të dërzohen fotografitë e repartit të prodhimit, makinave egzistuese apo mekanizmit si dhe kartelave të mjeteve themelore për ato, 3 fatura për mallin e dorëzuar apo punimet nga periudha e mëparshme.**

Në sektorin G mjetet nuk mund të përdoren drejtpërdrejtë për tregëtinë komerciale, siç është prokurimi i pajisjeve të mjeteve të transportit për objektet komerciale dhe të tilla.

Mjetet e pakthyeshme nuk janë të dedikuara për:

- 1) aktivitetet dhe projektet për të cilat tashmë është aprovuar një formë e ndihmës shtetërore;
- 2) mjetet e përhershme qarkulluese;
- 3) projektet e amviserive bujqësore individuale të regjistruara;
- 4) projekte që kanë të bëjnë me partitë politike;
- 5) projekte që kanë lidhje me:
 - a. industrinë e duhanit;
 - b. prodhimin e pijeve alkoolike të distiluara;
 - c. basteve dhe lojërave të fatit;
 - d. armatim dhe municion;
- 6) kryerjen e shërbimeve të regjistruara në sektorët H - komunikacion dhe magazinim; I - shërbimet e akomodimit dhe shërbimet ushqimore; J - informim dhe komunikim; K - veprimtari financiare dhe të sigurimit; L -

bizneseve me pasuri të patundshme; M - veprimtari profesionale, shkencore, inovatore dhe teknike; N - veprimtari të shërbimit administrativ dhe ndihmës; O - administratë shtetërore dhe mbrojtje; sigurimi social të detyrueshëm; P - arsim; Q – mbrojtja shëndetësore dhe mbrojtja sociale; R - art; argëtim dhe rekreacion; S - veprimtari të tjera shërbyese; T - veprimtarinë e ekonomisë familjare si punëdhënë; veprimtarinë e familjeve që prodhojnë mallra dhe shërbime për nevojat e tyre; U - veprimtaritë e organizatave dhe trupave eksteritoriale në Klasifikimin e Veprimtarive (prezantimi në faqen e internetit të Entit Republikan të Statistikave, www.stat.gov.rs).

Vërejtje: mundësi të jashtëzakonshme për ndarjen e mjeteve edhe në sektorin G – kur përveç tregëtisë në të madhe dhe të vogël, sipërmarrjet në afarizmin e tyre kanë edhe veprimtarinë prodhuese, dhe me këtë rast është e nevojshme të dërzohen fotografitë e repartit të prodhimit, makinave egzistuese apo mekanizmit si dhe kartelave të mjeteve themelore për ato, 3 fatura për mallin e dorëzuar apo punimet nga periudha e mëparshme.

II KUSHTET E KONKURSIT

Të drejtë në shfrytëzimin e mjeteve të pakthyeshme kanë bartësit e aplikacioneve të cilat i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) kushtet themelore

- 1) ta kenë dorëzuar formularin e plotësuar të aplikimit të Shërbimit të Trupit Koordinues me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me këtë program dhe konkursin e publikuar;
- 2) që për të njëjtat qëllime nuk kanë përdorur fonde inkurajuse që vijnë nga buxheti i Republikës së Serbisë, buxheti i vetëqeverisjes lokale ose organizatave donatore dhe se në vitin fiskal aktual dhe dy vite paraprake nuk iu është dhënë ndihma shtetërore de minimis në vlerë deri në 23.000.000,00 dinarë;
- 3) të kenë të siguruar fondet e tyre për bashkëfinancimin e projektit (shlyerjen e detyrimeve nga fondet individuale për blerjen e pajisjeve me anë të lëshimit ose kompensimit nuk është e lejuar);
- 4) të kenë të shlyera detyrimet në bazë të tatimit dhe kontributeve;
- 5) të kenë të shlyera të gjitha detyrimet në bazë të taksave lokale;
- 6) të jenë në pronësi shumicë private;
- 7) të jenë të regjistruar në Agjencinë për Regjistrat e Bizneseve; që brenda një viti para paraqitjes së kërkesës, nuk iu është shqiptuar masa e plotëfuqishme e ndalimit të kryerjes së veprimtarisë;
- 8) të ekzistojë dhe veprojë për të paktën dy vjet në territorin e komunave të Preshevës, Bujanocit ose Medvegjës - që selia e ndërmarrjes duhet të jetë në territorin e komunave Preshevë, Bujanoc ose Medvegjë të paktën nga viti 2020 (të kenë raporte financiare mbi veprimtarinë për dy vitet e fundit - 2020 dhe 2021);

- 9) që deri në ditën e paraqitjes së kërkesës të kenë të paktën dy të punësuar për një periudhë të pacaktuar kohore (vërtetim është formulari i aplikimit M4 dhe/ose MA);
- 10) që llogaria e parashtruesit të kërkesës nuk është bllokadë në periudhën prej 1 janarit 2022;
- 11) që ndaj tyre nuk është nisur procedurë e falimentimit apo procedurë e likuidimit;
- 12) që nuk janë në vështirësi, ndërsa sipas definicionit të mëposhtëm:

Subjekti ekonomik në vështirësi është subjekti ekonomik që nuk është në gjendje të parandalojë humbjet nga fondet e veta, fondet e pronarëve/aksionarëve të tij ose të besuarëve ose fondet nga burimet e tjera në treg, dhe të cilat pa intervenimin e shtetit, për një kohë të shkurtë dhe të mesme do të rrezikojë mbijetesën e tij.

Subjekti ekonomik është në vështirësi:

- nëse përgjegjësia për borxhet e tij është e kufizuar dhe ai ka humbur më shumë se gjysmën e kapitalit themelor, nga të cilat mbi një të katërtën e kapitalit themelor e ka humbur në 12 muajt e fundit;

- nëse të paktën një person në mënyrë të pakufizuar përgjigjet ndaj borxheve të tij dhe raportet financiare tregojnë se kapitali i tij është zvogëluar për më shumë se gjysma, nga të cilat më shumë se një e katërta e kapitalit është humbur në 12 muajt e fundit;

- nëse plotëson kushtet për hapjen e një procedure falimentimi.

Subjekti ekonomik është në vështirësi edhe nëse asnjë nga kushtet e përmendura në paragrafin 1 të kësaj pike nuk është plotësuar, nëse ka shenja të dukshme se është në vështirësi, si rritja e humbjeve, reduktimi i të ardhurave totale, rritja e stokeve, kapaciteti i tepërt, zvogëlimi i rrjedhave të mjeteve monetare, rritja e borxhit, rritja e kostove të interesit dhe rënia ose nultra neto e vlerës së pronës. Në kushtet më të vështira është një subjekt biznesi i cili është i paaftë për të paguar (insolvent) ose ndaj të cilit është hapur procedura e falimentimit.

b) kushtet specifike

Një subjekt ekonomik nga territori i një komune mund të paraqesë maksimum një paraqitje të propozimit të projektit për financim e projektit.

Me rastin e dorëzimit të paraqitjes, selia qendrore e subjektit ekonomik duhet të jetë në territorin e komunës së Preshevës, Bujanocit ose Medvegjës së paku nga viti 2020.

Subjektet afariste që kanë marrë fonde në konkursin e shpallur në bazë të Programit të masave për ndarjen dhe përdorimin e fondeve për subvencione për kompanitë private në vitin 2019, 2020 dhe 2021 në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, nuk kanë të drejtë të aplikojnë për këtë konkurs. Përndryshe, paraqitja e tyre do të refuzohet si të palejuara.

Subjektet e ekonomike që kanë marrë mjete të pakthyeshme për subvencionet në konkursin e Shërbimit të Trupit Koordinues të vitit 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2018 kanë të drejtë të aplikojnë për konkursin e vitit 2022.

Me rastin përzgjedhjes së paraqitjeve përparsi do t'i jepet subjekteve ekonomike që nuk kanë marrë mjete të pakthyeshme për subvencione në konkursin e Shërbimit të Trupit Koordinues.

Aplikacionet e subjekteve ekonomike kundër të cilit udhëhiqet procedurë gjyqësore për mospërmbushjem të detyrimeve sipas Kontratës me Shërbimin e Trupit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, mbi ndarjen e subvencioneve në bazë të konkurseve të mëparshme, do të refuzohen si të palejuara.

c) Kuadri financiar

Shërbimi i Trupit Koordinues do të bashkëfinancojë deri në 70% (neto) të kostove (përfshirë taksën e vlerës së shtuar) të prokurimit për masën I dhe masën II nga pika 1.3, për ndërmarrjet mikro dhe të vogla dhe sipërmarrësit.

Kostot nuk përfshijnë taksën e vlerës së shtuar, pagesa e së cilës është përgjegjësia e vet aplikuesit.

Grantet jepen në përputhje me qëllimin e fondeve të përmendura në pikën 1.3, si vijon:

a) Sipërmarrësit aplikojnë për alokimin e fondeve sipas kriterëve të mëposhtme:

1. Sipërmarrësit që nuk kanë detyrimin të mbajnë libra biznesi (paushallët) mund të aplikojnë për fonde në shumën maksimale deri në 2.000.000,00 dinarë. E rëndësishme për ndarjen është mesatarja e të ardhurave neto të realizuara në periudhën e dy viteve të kaluara, në shumën e dyfishtë të fondeve të kërkuara.

2. Sipërmarrësit që mbajnë librat e biznesit nën sistemin e kontabilitetit me dy hyrje mund të aplikojnë deri në shumën maksimale 3.000.000,00 dinarë në të njëjtat kushte si sipërmarrësit me tatim paushall, me kusht që përveç dyfishit të shumës së të ardhurave ata mund të kenë dyfishin e vlerës së pasurive të pashkruara gjegjësisht të mjeteve të përhershme.

b) ndërmarrjet mikro dhe të vogla dhe sipërmarrësit nga fusha e industrisë së përpunimit, industrisë së ndërtimit, industrisë së riciklimit, të cilat janë kryesisht të angazhuara në prodhim, aplikojnë për ndihmë financiare në shumën maksimale:

1) në vlerën deri në 3.000.000,00 dinarë, pa taksë mbi vlerën e shtuar, për projektet për blerjen e pajisjeve me qëllim të rritjes së kapacitetit të prodhimit ekzistues, rritjes së produktivitetit dhe cilësisë ose sigurimin e një faze më të lartë të përpunimit të produktit;

2) në vlerë deri në 3.000.000,00 dinarë, pa përfshirë taksën e vlerës së shtuar, për projektet për blerjen e pajisjeve për prodhimin e produkteve të reja, produkte me vlerë të shtuar bruto më të lartë, rritje të mundësive të eksportit, gjegjësisht zëvendësimin e eksportit ose zgjerimin e tregut të shitjeve ose përmirësimin e pozicionimit të tregut, prokurimi i pajisjeve për prodhimin e paketimit të produkteve të reja ose paketimit të produkteve të reja, prokurimi i pajisjeve për zbatimin e shërbimeve të regjistruara në sektorët A deri F (G) të Klasifikimit të Veprimtarive.

Subjektet afariste janë të detyruara të financojnë shumën e mbetur të fondeve nga burimet e tyre, nga fondet që nuk vijnë nga buxheti i Republikës së Serbisë, nga buxheti i vetëqeverisjes lokale ose organizatave donatore. Fondet individuale për projekte të bashkëfinancimit duhet të sigurohen në të holla. Shlyerja e detyrimeve nga fondet e veta për blerjen e pajisjeve me cesion ose kompensim nuk është e lejuar. Shuma e ndihmës së pakthyeshme të aprovuar nuk mund të jetë më e vogël se 300.000,00 dinarë, pa tatimin e vlerës së shtuar.

Fondet do të përdoren në mënyrë që Shërbimi i Trupit Koordinues të bëjë pagesa direkte me profaturë tek furnizuesi ose furnitori, i zgjedhur nga shfrytëzuesi i fondeve.

Fondet për realizimin e masës nuk mund të përdoren për: detyrimet e mbetura në bazë të takasve dhe tatimeve, kredive dhe kësteve për shlyerjen e kredisë; kostot e garancioneve, polisat e sigurimit, intereset, kostot e operacioneve bankare, trajnimet, çertifikimi i produkteve, diferencat e kursit të këmbimit; kostot doganore dhe administrative, kreditimi i palëve të treta, shërbimet e këshillimit, kostot e hartimit të propozimeve të projektit dhe mbledhja e dokumenteve për të aplikuar për konkurs, kostot e transportimit të pajisjeve, kostot e ekspertizës, trajnimin e punonjësve dhe shërbimeve të tjera të lidhura me projektin.

Investimet fillestare dhe vendet e reja të krijuara të punës në lidhje me këto investime duhet të jetësohen në të njëjtën zonë, përkatësisht rajon, për të paktën tre vjet pas përfundimit të projektit.

III DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

- 1) Formulari i plotësuar në mënyrë të rregullt, i vulosur dhe i nënshkruar - Formulari numër 1A ose 1B;
- 2) Deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur për pranimin e kushteve për ndarjen e fondeve - Formulari numër 2;
- 3) Lista e regjistrimit të mjeteve themelore më datë 31 dhjetor v.2021;
- 4) Formulari i plotësuar, nënshkruar dhe vërtetuar i kostos së projektit me strukturën bashkëfinancuese të parashtruesit të Paraqitjes, duke treguar burimet e fondeve për bashkëfinancimin e projektit - Formulari nr. 3;
- 5) Aryetim me të cilin shpjegon se si pajisjet e blera do të kontribuojnë në reduktimin e konsumit të energjisë për njësi të prodhimit dhe të cilat detyrimisht duhen të përmbajnë:
 - a) Në rast të ndryshimit të pajisjeve egzistuese:
 - karakteristikat teknike të pajisjes së re që është lëndë e prokurimit, si dhe atyre ekzistuese me të dhënat e detyrueshme për konsumin e energjisë për njësi të prodhimit ose në baza vjetore dhe numrin e orëve të punës gjatë vitit;
 - nëse pajisja shënohet me një klasë ose me disa etiketa të tjera të efikasitetit të energjisë, është e detyrueshme të tregohen të dhënat për pajisjet ekzistuese dhe të reja;
 - masat e avansimit të efikasitetit të energjisë në prodhim të cilat do të merren së bashku me instalimin e pajisjeve të reja;
 - b) Në rast instalimi të pajisjeve të reja;
 - karakteristikat teknike të pajisjeve të reja që janë subjekt i prokurimit, me të dhënat e kërkuara për konsumin e energjisë për njësi të produktit ose për çdo vit dhe numrin e orëve të punës gjatë vitit;

- nëse pajisja shënohet me një klasë ose me ndonjë etiketë tjetër të efikasitetit të energjisë, është e detyrueshme të sigurohet informacioni;

- masat për të përmirësuar efikasitetin e energjisë në prodhimin që do të ndërmerren me instalimin e pajisjeve të

- 6) Vendimi i parashtruesit të kërkesës mbi furnizuesin e zgjedhur, gjegjësisht furnizuesit me arsyetim dhe profakturë.

Dokumentacioni i cili sigurohet në përputhje me nenin 9 dhe 103 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e RS-ës”, nr 18/16 dhe 95/18 – interpretim autenitëk)

- 1) Vërtetimi nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve;
- 2) Akti i Themelimit të parashtruesit të kërkesës (originali ose fotokopja e vërtetuar);
- 3) Raportet vjetore financiare për vitin 2020 dhe 2021 (bilanci gjendjes, bilanci i të ardhurave dhe shtojca statistikore) të vërtetuara nga kontabilisti dhe përfaqësuesi ligjor i subjektit ekonomik me listën e regjistrimit të mjeteve themelore në ditën 31 dhjetor v.2021; (për sipërmarrësit të cilët udhëheqin kontabilitet të thjeshtë nuk dorëzohet bilanci i gjendjes),
 - sipërmarrësit dorëzojnë vëllimin e të hyrave të realizuara dhe shërbimeve të prodhimit në 2020 dhe 2021, numrin e kontratave të lidhura me klientët, numrin e klientëve me të cilët është lidhur një kontratë dhe vlerën e kontratave të lidhura me klientët,
- 4) Formularin M4 dhe/apo MA për punonjësit,
- 5) Vërtetimin origjinal i degës kompetente të Administratës Tatimore se aplikanti ka shlyer të gjitha detyrimet për tatimet dhe kontributet që përfundojnë me datën e publikimit të ftesës publike;
- 6) Vërtetimin origjinal e organit kompetent të vetëqeverisjes lokale që aplikanti ka shlyer të gjitha obligimet ndaj vetëqeverisjes lokale që përfundojnë me datën e publikimit të ftesës publike;
- 7) Vërtetimin origjinal të organit kompetent që personit juridik në vitin e fundit para publikimit të ftesës publike nuk iu është shqiptuar një masë e plotëfuqishme e ndalimit të kryerjes së veprimtarisë – i lëshuar pas shpalljes së konkursit;
- 8) Vërtetimi i Bankës Kombëtare të Serbisë se llogaria e aplikantit nuk është i bllokuar që nga 1 janari 2022 – i lëshuar pas shpalljes së konkursit;
- 9) Vërtetimi i Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve ose gjykatës kompetente që kundër tyre nuk është iniciuar procedura e falimentimit ose likuidimit, të lëshuara pas shpalljes së konkursit;

IV AFATI PËR PARAQITJE DHE PËR DORËZIMIN E DOKUMENTEVE

Afati për dorëzimin e paraqitjeve në konkurs është deri më date 10.06.2022.

Parashtruesit, paraqitjet e tyre së bashku me dokumentacionin përcjellës duhet t'ia dorëzojnë Shërbimit të Trupit Koordinues personalisht apo me postë rekomanduese në adresën:

Shërbimi i Trupit Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat
Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë

Bulevar Mihaila Pupina 2, 11 070 Novi Beograd

Paraqitjet dorëzohen në zarfën e mbyllur dhe të vulosur me shënimin „Prijava za konkurs – za sredstva za subvencije privatnim preduzećima u 2022. godini u opština Preševo, Bujanovac i Medveđa, sa napomenom „NE OTVARATI PRE ISTEKA ROKA“, me emrin e plotë dhe adresën e dërguesit në pjesën mbrapa të zarfit.

Paraqitjet të cilat nuk dorëzohen sipas mënyrës së paraparë të lartpërmendur nuk do të shqyrtohen.

V NDARJA E MJETEVE

Shikimin, kontrollimin e rregullësive formale, vlerësimin e aplikacioneve dhe sjelljen e vendimit mbi ndarjen e fondeve të subvencionimit kryhet nga ana Komisioni, i cili formohet me vendim të u.d të drejtoreshës së Shërbimit të Trupit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Çdo paraqitje vlerësohet në bazë të kriterëve për vlerësimin e paraqitjeve dhe përpilohet rang lista e bazuar në numrin e pikëve në përputhje me kriteret.

Do të merren parasysh vetëm aplikacionet e dorëzuara në mënyrë complete dhe në kohë.

Në përputhje me kriteret e përcaktuara, Komisioni do të kryejë renditjen e aplikacioneve për shpërndarjen e fondeve. Komisioni pas rangimit të kryer, në bazë të autorizimit nga vendimi, në afat prej 15 ditëve nga data e skadimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve, do të sjellë vendim për përzgjedhjen e aplikacioneve për të cilat do të jepen mjetet e pakthyeshme, të cilën e nënshkruan kryetari/ja i/e Komisionit.

Kandidatët, paraqitjet e të cilëve janë refuzuar nga Shërbimi Trupi Koordinues kanë të drejtë ankese brenda 15 ditëve nga data e marrjes së vendimit për ndarjen e fondeve, në përputhje me nenin 32 dhe 147 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në ankesë duhet të theksohet vendimi i kontestuar, numri dhe datën e vendimit, arsyet për paraqitjen e ankesës dhe arsyetimi.

Ankesa i parashtrohet u.d të drejtoreshës së Shërbimit të Trupit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, ndërsa përmes Komisionit për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Aplikacioneve për Caktimin e Fondeve për Subvencione për Bizneset në Pronësi Private, në adresën e Shërbimit të Trupit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, përkatësisht në adresën Bulevar Mihaila Pupina 2, 11070 Novi Beograd, Beograd.

Rreth ankesës vendos u.d e drejtoreshës së Shërbimit të Trupit Koordinues brenda 15 ditëve nga data e pranimit të ankesës.

Vendimi i u.d së drejtoreshës sipas ankesave të paraqitura është përfundimtar në procedurën administrative.

Mjetet e pakthyeshme të miratuara do të paguhen në llogarinë e furnizuesit, gjegjësisht dorëzuesit.

Shërbimi i Trupit Koordinues do të nënshkruajë kontratë treshe, me shfrytëzuesit e fondeve dhe furnizuesit, gjegjësisht dorëzuesit që ata kanë zgjedhur.

Aktiviteti për të cilin miratohet fondi, si dhe të gjitha pagesat që lidhen me realizimin e tij, duhet të fillohen pas nënshkrimit të kontratës dhe të përfundohen brenda 6 muajve nga data e lidhjes së kontratës.

Shfrytëzuesi i mjeteve dhe furnizuesi i pajisjeve janë të detyruar që me rastin e nënshkrimit të kontratës me Shërbimin e Trupit Koordinues Trupit të dorëzojnë: kambialin dhe autorizimin e kambialit dhe kërkesën për evidentimin e kambialit.

Tek pajisjet importuese, FURNITORI I HUAJ është i detyruar që të siguroj garancionin bankar në dobi të Shërbimit të Trupit Koordinues

Me rastin e nënshkrimit të kontratës, furnizuesi, gjegjësisht furnitori është i detyruar të paraqesë vërtetimin origjinal të Agjencisë për Regjistrat e Bizneseve për subjektet ekonomike vendore, gjegjësisht organit tjetër kompetent për bizneset e huaja, që ndaj tyre nuk është inicuar procedura e likuidimit ose falimentimit. Vërtetimi duhet të jetë lëshuar pas shpalljes së konkursit.

Përfituesi i fondeve gjithashtu është i detyruar të paraqesë edhe kërkesën për pagesën e fondeve tek Shërbimi i Trupit Koordinues.

Aplikuesi duhet pas përfundimit të aktiviteteve/projekteve të dorëzojë Shërbimit të Trupit Koordinues raportin mbi realizimin e aktiviteteve/projekteve të bashkë-financuara përmbajtja e të cilit dhe afati i fundit për dorëzimin do të definohen në kontratë.

Dokumentacioni i theksuar duhet të dorëzohet Shërbimi të Trupit Koordinues në afat prej tridhjetë ditëve pas përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

VI FORMULARËT E KONKURSIT

Formularët e konkursit dorëzimin e paraqitjeve janë në dispozicion në faqen e internetit të Trupit Koordinues www.kt.gov.rs dhe në faqen e internetit të komunës Preshevës www.presevo.rs, Bujanocit www.bujanovac.rs dhe Medvegjës www.medvedja.org.rs.

Për pyetje shtesë mund të drejtoheni ekskluzivisht në formë të shkruar në adresën elektronike: fatos.mustafa@kt.gov.rs